



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1539/prot.
16

Tiranë, më 18/05/2020

URDHËR

Nr. 327, datë 18.05.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË URDHRIN NR 193 DATË 20.03.2020 “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik si dhe Vendimit nr. 2357 datë 16.05.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirusi i ri me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në Urdhrin nr.193 datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e urdhërit fasha orare zgjatet deri në orën 21:00.
2. Paragrafi i parë e pikes 1\1 shfuqizohet.
3. Në të gjithë vendin, hiqen autorizimet për lëvizjen e këmbësorëve apo automjeteve gjatë javës.
4. Çdo parashikim në udhërat e mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

